

Agro Iliria Group Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 22

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	6,974,227	47,528,678
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	11,418,969	9,254,609
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	157,893	15,550,361
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	73,914,692	70,018,676
Inventari	8	15,609,777	462,530
Shpenzime të shtyra	9	195,524	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		108,271,082	142,814,854
Aktivet afatgjata			
Aktive biologjike	10	226,892,500	206,067,488
Aktive afatgjata materiale	10	268,950,115	242,243,732
Totali i aktiveve afatgjata		495,842,615	448,311,220
Totali i aktiveve		604,113,697	591,126,074
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	36,790,691	-
Llogari të pagueshme tregtare	12	60,681,095	52,075,792
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	402,330,131	366,293,849
Detyrime tatimore	14	633,536	31,919
Të tjera detyrime	15	11,166,720	16,065,940
Totali i detyrimeve afatshkurtra		511,602,173	434,467,500
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	98,570,970	157,689,600
Totali i detyrimeve afatgjata		98,570,970	157,689,600
Totali i detyrimeve		610,173,143	592,157,100
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Fitime/Humbje të pashperndara		(1,131,026)	(1,131,026)
Fitimi i ushtrimit		(5,028,420)	-
Totali i kapitalit		(6,059,446)	(1,031,026)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		604,113,697	591,126,074

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	178,321	-
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(4,665,226)	-
2) Të tjera shpenzime	19	(4,665,226)	-
Shpenzime të personelit		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		-	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(197,803)	-
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	21	(343,712)	-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(108,550)	-
2) Shpenzime të tjera financiare		(235,162)	-
Fitimi/humbja para tatimit		(5,028,420)	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	-	-
Fitimi/humbja e vitit		(5,028,420)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(5,028,420)	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AGRO ILIRIA GROUP sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	(1,131,026)		(1,031,026)
Fitimi / Humbja e vitit			-	-
Lëvizjet përmes kapitalit				-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2019	100,000	(1,131,026)	-	(1,031,026)
Fitimi / Humbja e vitit			(5,028,420)	(5,028,420)
Lëvizjet përmes kapitalit			-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	100,000	(1,131,026)	(5,028,420)	(6,059,446)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

Shpëtim Oseku
Shpëtim Oseku
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(5,028,420)	-
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	161,790	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(6,255,900)	(71,038,628)
Rënie/(rritje) në inventarë	(15,147,247)	(462,530)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	3,308,722	(13,423,501)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	998,978	(684,290)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(21,962,077)	(85,608,949)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(47,531,395)	(3,959,693)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(47,531,395)	(3,959,693)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	51,042,406	132,736,295
Pagesa e huave	(22,327,939)	(2,479,846)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	28,714,467	130,256,449
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(40,779,005)	40,687,807
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	47,528,678	6,840,871
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	224,554	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 6,974,227	47,528,678

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Agro Iliria Group” sh.p.k (Kompania) me nipt L51320033L është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 19/01/2015 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërise është 100,000 Lekë, i ndarë në 2 njësi të barabarta me nga 50,000 Lekë secila.

Ortakët e shoqërise janë:

- Z. Shpëtim Oseku zotërues i 1 kuote ose 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Ilir Trebicka zotërues i 1 kuote ose 50% të kapitalit të shoqërisë;

Aktiviteti kryesor Eksport - importi i të gjitha produkteve dhe nënprodukteve bujqësore, blegtorale, ushqimore, të hortikulturës, alkalike dhe jo alkoolike të prodhuara nga këto produkte, lëndëve të para, agroinputeve dhe materialeve biologjike që shërbejnë për këto sektore dhe agroindustrinë etj. Shoqëria do të meret me prodhimin, grumbullimin dhe seleksionimin e bimëve e frutave të ndryshme, bimëve medicinale dhe luleve, pemëve dekorative, disa produkte blegtorale, pyjore, zhvillimin e agroturizmit, akuakultures etj. Shoqëria do të shërbejë gjithashtu si një qendër private e shërbimit këshillimor, dhënie e asistencës dhe mbështetjes teknike, trajnim dhe konsulencë drejtimi e menaxhimi si dhe certifikim për sa i përket cilësisë dhe standarteve të produkteve të përmendura sa më sipër.

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 33 punonjës (2019: 1 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga SNK për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Euro/ALL	123.70	121.77
USD/ ALL	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta dhe vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet biologjike

Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur:

- (a) njësia ekonomike kontrollon aktivin / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara;
- (b) është e mundur që në njësinë ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin / produktin bujqësor; dhe
- (c) vlera e drejtë ose kosto e aktivitetit / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.

Njohja e aktiveve biologjike bëhet zakonisht në momentin e blerjes. Njohja bëhet gjithashtu kur aktivitetet biologjike gjenerohen / krijohen nga aktivitetet ekzistuese. Prodhimi bujqësor, i pandarë (pavjelur, pakorrur, palindur, paqethur, etj) nga një aktiv biologjik, nuk njihet si aktiv më vete. Zakonisht njësia ekonomike bën shpenzime gjatë gjithë jetës së dobishme të një aktiviteti biologjik. Këto shpenzime kontabilizohen dhe përfshihen si pjesë e vlerës kontabël të aktiveve biologjike, vetëm nëse ato i plotësojnë kriteret e njohjes si aktiv

Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë.

(Vlerat janë në Lek)

3.5. Aktivet biologjike (vazhdim)

Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruara nga aktivet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në kohën e vjeljes. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.14. Aktivët dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	6,845,458	394,286
Llogari rrjedhëse	6,845,458	394,286
Mjete monetare në arkë	128,769	47,134,392
	<u>6,974,227</u>	<u>47,528,678</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	11,418,969	9,254,609
	<u>11,418,969</u>	<u>9,254,609</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme tregtare nga palët e lidhura	157,893	15,550,361
	<u>157,893</u>	<u>15,550,361</u>

*(Vlerat janë në Lek)***7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim mbi fitimin	56,250	56,250
TVSH e arkëtueshme	73,856,270	69,962,426
Te drejta ndaj Doganes	2,172	-
	<u>73,914,692</u>	<u>70,018,676</u>

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Lëndë e parë dhe materiale	866,609	-
Materiale ambalazhi	2,722,000	-
Produkt I gatshem per shitje	12,021,168	462,530
	<u>15,609,777</u>	<u>462,530</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Siguracione	37,068	-
Të tjera shpenzime të periudhave të ardhme	158,456	-
	<u>195,524</u>	<u>-</u>

*(Vlerat janë në Lek)***10. Aktive afatgjata materiale dhe Aktive biologjike**

	Makineri Pajisje	Mjete transporti	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	Aktive biologjike	Ndertime dhe instalime	Te tjera	Totali
Kosto									
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	6,722,796	13,692,719	60,417	100,329	74,980,800	206,067,488	146,480,839	205,832	448,311,220
Shtesa	7,064,824	1,974,487	149,998	66,146	340,000	-	15,957,686	1,153,242	26,706,383
Pakesime per te ardhurat e relaizuara nga shitja gjate fazes se maturimit						(20,509,126)			(20,509,126)
Shtesa kostot operativee gjate fazes se maturimit						41,334,138			41,334,138
Pakësime									-
Gjëndja më 31 dhjetor 2020	13,787,620	15,667,206	210,415	166,475	75,320,800	226,892,500	162,438,525	1,359,074	495,842,615

*(Vlerat janë në Lek)***10. Aktive afatgjata materiale dhe Aktive biologjike (vazhdim)**

	Makineri Pajisje	Mjete transporti	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Instrumenta dhe vegla pune	Aktive biologjike	Ndertime dhe instalime	Te tjera	Totali
Amortizimi i akumuluar									
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2020	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlera neto kontabël									
Gjendja më 31 dhjetor 2019	6,722,796	13,692,719	60,417	100,329	74,980,800	206,067,488	146,480,839	205,832	448,311,220
Gjendja më 31 dhjetor 2020	13,787,620	15,667,206	210,415	166,475	75,320,800	226,892,500	162,438,525	1,359,074	495,842,615

Gjate fazes se maturimit te bimes te gjitha kosto operative kalojne ne rritje te vleres se asetit biologjik dhe te gjitha te ardhurat qe relizohen gjate kesaj periudhe nga shitja e frutave te prodhuara nga bima shkojne ne ulje te velerse se asetit biologjik sipas kerkesave te standarti kombetar te kontabiliteti SKK13.

*(Vlerat janë në Lek)***11. Hua aftashkurta**

Në këtë zë është paraqitur detyrimi ndaj kredisë dhe leasing për periudhen një vjecare të kësteve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kestet e qirase financiare Porsche Leasing	423,707	-
Kestet e huase per nje vit nga OTP Bank	36,366,984	-
	<u>36,790,691</u>	<u>-</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë	58,281,609	52,075,792
Furnitorë për fatura të pambërritura	2,399,486	-
	<u>60,681,095</u>	<u>52,075,792</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme të tjera ndaj ortakeve	402,330,131	366,293,849
	<u>402,330,131</u>	<u>366,293,849</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	368,550	22,320
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	139,565	6,500
Tatim në Burim	85,641	3,099
Gjopa për tu paguar për TVSH-në	39,780	-
	<u>633,536</u>	<u>31,919</u>

*(Vlerat janë në Lek)***15. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga për t'u paguar	1,063,518	64,540
Detyrime per qirane e zyres	245,802	-
Të tjera detyrime	9,857,400	16,001,400
	<u>11,166,720</u>	<u>16,065,940</u>

16. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kredi nga OTP Bank	97,856,759	155,497,260
Qira financiare nga Porsche Leasing	714,211	2,192,340
	<u>98,570,970</u>	<u>157,689,600</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerë 100,000 Lekë. Gjate vitit 2020 nuk ka pasur ndryshim në strukturën e kapitalit të shoqërisë.

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitime nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	298,339	-
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(120,018)	-
	<u>178,321</u>	<u>-</u>

(Vlerat janë në Lek)

18. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave në pasqyrën e performances me shitjet e deklaruar sipas FDP-ve të TVSH:

	31 dhjetor 2020
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	20,508,771
Deklaruar me pak në FDP e TVSH	355
Kapitalizuar në kosto aktivi biologjik	(20,509,126)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	-
Te ardhura nga shitja e produkteve dhe transportit	20,509,126
Kapitalizuar në kosto aktivi biologjik	(20,509,126)
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	-
Të ardhura të tjera financiare	151,608
Fitim nga kembimet valutore	298,339
Total të ardhura të deklaruar FDP-në e Tatim Ftimit	449,947

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime qiraje	289,176	-
Shpenzime për konsulentë	459,000	-
Tarifa aplikimi	10,333	-
Blerje të ndryshme, kancelari etj	74,633	-
Publicitet, reklama dhe shpenzime promovionale	94,333	-
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	28,465	-
Komisione bankare	250,562	-
Shpenzime përfaqësi	250,920	-
Shpenzime inspektimi dhe analiza laboratorike	250,609	-
Shpenzime të tjera	45,393	-
Taksa dhe tarifa të ndryshme	197,515	-
Sigurime	482,090	-
Shpenzime noteriale	20,600	-
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	2,200,767	-
Shpenzime utilitare	10,830	-
	4,665,226	-

*(Vlerat janë në Lek)***20. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjopa dhe penalitete	197,803	-
	<u>197,803</u>	<u>-</u>

21. Shpenzime/Të ardhura financiare neto

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	(108,608)	-
Të ardhura nga interesat	58	-
Shpenzime të tjera financiare	(368)	-
Të ardhura të tjera financiare	151,550	-
Humbje nga këmbimet valutore	(386,344)	-
	<u>(343,712)</u>	<u>-</u>

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Fitimi para tatimit	(5,028,420)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,398,570
Shpenzime pritje & percjellje, dhurata	1,741,716
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	197,803
Pjese kembimi dhe materiale konsumi	68,277
Shpenzime të tjera	390,774
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(2,629,850)
Tatim fitimi	-
	<u>(5,028,420)</u>

(Vlerat janë në Lek)

30. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2020, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

31. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.